

**TË BESUARIT E VËRTETË
AKIDA
DHE VEPRAT TË CILAT TË NXJERRIN NGJA ISLAMI**



Mitrovicë, 1417-1996
"MIRËSIA"

Titulli në origjinal:

**ISTINSKO VJEROVANJE - AKIDA
I DJELA KOJA IZVODE IZ ISLAMA**

Në përkthim:

**TË BESUARIT E VËRTET - AKIDA
DHE VEPRAT TË CILAT TË NXJERRIN NGJA ISLAMI**

Përktheu dhe përshtati nga boshnjakishtja:

NIG'JAR BAJRAMI HOTI

Recenzoi:

Rexhep Lushta

Lektor dhe Korrektor:

Ammar Hoti

Realizimi kompjuterik:

Shtëpia grafiko botuese:

"A G O R A"

Mitrovicë



Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit !

Falënderimi i qoftë All-llahut të Madhërishëm, paqa dhe shpëtimi qofshin mbi robërit (të dërguarit) e Tij të zgjedhur. Dije mirë, Zoti të udhëzoi në rrugë të drejtë dhe dije që All-llahu xh.sh. i krijoi njerëzit që vetëm Atë ta adhurojnë dhe asgjë të mos i përshkruajnë si shok.

All-llahu i Madhërishëm thotë:

“Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh -Dhariatë, 56)

Detyrë e çdo muslimani dhe muslimaneje është që ta njohin Zotin e tyre dhe që të jenë vetëm robërit e Tij.

Sikur që e kanë obligim ta njohin Lajmëtarin e fesë së tyre Muhammedin s.a.w.s. dhe fenë e tyre Islamin, që të bëhen besimtarë dhe besimtare të vërtetë.

NJIHE ZOTIN - SUNDUESIN TËND

Thuani vëllezër dhe motra: Zoti ynë është All-llahu xh.sh. i cili na krijoi nga asgjëja dhe na dhuroi me begati të pafund. All-llahu xh.sh i krijoi Qiellin dhe Tokën, Diellin dhe Hënë, Natën dhe Ditën.

Dëshmi e këtyre janë fjalët e të Madhërishmit:

“Vertetë, Zoti juaj, All-llahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arsh, Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon atë e edhe dielli, edhe hëna e edhe yjet i janë të nënshtruar sundimit të Tij...” (El -

A'rafë, 54)

Zoti ynë e jep shiun, bënë që të mbijnë të mbjellat dhe u jep furnizimin robërve të vet. Vetëm Ai meriton që me të vërtetë të adhurohet.

Zoti ynë na krijoi që të jemi robërit e Tij, që t'i nënshtrohemi dhe që vetëm Atë ta adhurojmë. Këtë e vërtetojnë edhe fjalët e Zotit të Madhërishëm:

“Unë nuk i krijoja xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh - Dharijatë, 56)

Nënshtrimi ynë i takon vetëm Atij e kjo është që:

Të kryejmë atë që na ka urdhëruar e t'i shmangemi asaj që na e ka ndaluar. Obligimi ynë i parë me të cilin All-llahu na ka obliguar është që t'i mohojmë (haptas dhe fshehëtas) “Tagutët” (të gjitha besimet e rrejshme) dhe të besojmë vetëm në Njërin dhe të Vetmin Zot, e Ai është All-llahu xh.sh.

Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është Dëgjues i Dijshëm.” (El - Bekare, 256)

Lidhja jonë më e fortë është: Kelimei shهادتي - La ilahe il-lall-llah - e kjo do të thotë që nuk ka Zot tjetër përveç Njërit dhe të Vetmit All-llah xh.sh., kurse nënshtrimi dhe adhurimi i takon vetëm Atij.

Prandaj i bëjmë ibadet All-llahut xh.sh. që na ka krijuar dhe e bëjmë atë që Zoti ynë dëshiron dhe atë me çka do të jetë i kënaqur, e bëjmë atë me fjalë dhe me vepra, haptas dhe fshehëtas, e bëjmë atë që Ai na ka urdhëruar e i shmangemi asaj që Ai na ka ndaluar.

All-llahu xh.sh. thotë:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin...” (El - Bejjine, 5)

“E kush adhuron me All-llahun edhe ndonjë zot tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, përgjegjësia e tij është para Zotit të vet, e mohuesit nuk do të shpëtojnë.” (El - Mu'minunë, 117)

Në të vërtetë ne pas vdekjes do të ringjallemi, All-llahu xh.sh. përsëri do të na ringjallë, e këtë e vërteton edhe Kur'ani:

“Prej asaj (tokës) Ne u krijuam ju, e ju do t'u kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë.” (Ta Ha, 55)

Në atë ditë, të gjithë do të japin llogari për veprat e veta, e ai i cili nuk beson në këtë është jobesimtarë - kafir. Dëshmi për këtë është ajeti Kur'anor:

“Ata që nuk besuan, menduan se kurrsesi nuk do të ringjallen. Thuaj: “Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjallen dhe do të njiheni me atë që keni punuar, e ajo për All-llahun është lehtë!” (Et - Tegabun, 7)

Prandaj t'i nënshtrohemi All-llahut xh.sh. Njërit dhe të Vetmit Zot dhe vetëm atë ta adhurojmë!

NJIHE LAJMËTARIN E FESË - MUHAMMEDIN S.A.W.S.

Fjalët: Eshhedu enne Muhammeden resulull - llah, domethënë “
Të besuarit që Muhammedi s.a.w.s. është i Dërguari i All-llahut

xh.sh., të besuarit e asaj me çka ka ardhur (shpalljet e tij), pasimi i asaj që ka urdhëruar, braktisja e asaj që e ka ndaluar dhe të besuarit që nuk ka nënshtrim tjetër ndaj All-llahut përveç asaj që ai ka urdhëruar.”

Lajmëtari i fesë, Muhammedi s.a.w.s. është djali i Abdull-llahut - djali i Abdul-Mutalibit - djali i Hashimit. Hashimi rrjedh nga fisi Kurejsh, ndërsa Kurejsh është fisi Arab. Arabët janë pasardhësit e Ismailit a.s., djalit të Ibrahimit a.s. mikut të All-llahut xh.sh. Nëna e Muhammedit s.a.w.s. është Amina. Muhammedi s.a.w.s. ka lidur në qytetin e Mekkes në Arabi, në vitin 570 - të.

Muhammedi s.a.w.s. është Lajmëtari - i Dërguari i fundit e njëkohësisht me i zgjedhuri i All-llahut xh.sh.

NJIHE FENË TËNDE - ISLAMIN

Thuani vëllezër e motra: Feja jonë është Islami, e kjo është përkushtimi dhe nënshtrimi i plotë vetëm ndaj All-llahut xh.sh. që do të thotë pasimi i urdhërave të Tij (shpalljeve), të shmangurit nga ajo që Ai e ka ndaluar dhe të larguarit nga ajo që të drejton kah shirku (të përshkruarit shok All-llahut xh.sh.). E të gjitha këto t'i bësh dhe t'i vërtetosh me fjalë dhe vepra. Feja jonë Islami ka tri kushte:

1. Islamin
2. Imanin
3. Ihsanin

ISLAMI

Islami ka pesë parime, e këto janë :

a) Kelimeit shehadeti.

La ilahe il-lall-llah, Muhammedun Resulull-llah - që domethënë të besuarit që vetëm All-llahu është Zot dhe që Muhammedi s.a.w.s. është i Dërguari i Zotit xh.sh. Dëshmi për këtë janë ajetet Kur'anore që vijnë:

1. **“All-llahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe melaiket e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij Fuqiptotit e të Urtit.”** (Ali Imran, 18)

2. **“Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i Dijshëm për çdo send.”** (El - Ahzab, 40)

b) Të kryerit e namazit.

Secili namaz e ka kohën e vet në të cilën falet. Tabela vijuese tregon fillimin dhe mbarimin e secilës kohë të namazit dhe numrin e rekateve të secilit namaz (fard).

Namazi	Fillimi i kohës	mbarimi i kohës	numri i rekateve
sabahu	agimi	lindja e diellit	(2) dy rekate (fard)
dreka	kur dielli kalon gjysmën e qiellit	kur hija e çdo gjëje rritet për dy herë	(4) katër rekate (fard)
ikindia	kur hija e çdo gjëje rritet për dy herë	perëndimi i diellit	(4) katër rekate (fard)
akshami	perëndimi i diellit	zhdukja e muzgut	(3) tri rekate (fard)
jacia	zhdukja e muzgut	gjysma e natës (mesnata)	(4) katër rekate (fard)

c) Dhënja e zekatit.

Namazi dhe zekati e kanë dëshmi ajetin icili thotë:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singhtë ndaj Tij, që të largohen prej besimit të kotë, të falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.” (El - Bejjine, 5)

d) Agjëimi i muajit të Ramazanit.

E që vërteton edhe ajeti Kur'anor:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El - Bekare, 183)

e) Kryerja e Haxhxhit

Të vizituarit e Bejtull-llahut (shtëpisë së All-llahut - Ka'bes), nëse për të ekzistojnë mundësitë. Duke u bazuar në Kur'an:

“...Për hirë të All-llahut, vizita e shtëpisë (Ka’bes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, ...” (Ali Imran, 97)

IMANI - TË BESUARIT

Imani është të besuarit në All-llahun xh.sh., Melekët e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe çdo gjë që ngjanë dhe ndodh, bëhet me vullnetin dhe përcaktimin e Tij (të besuarit në Kader).

IHSANI - BËMIRËSIA

Ihsani është ta adhurosh All-llahun xh.sh. sikurse ta shohësh, sepse ti edhe nëse nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë ty të sheh. All-llahu i Madhërishëm thotë:

“S’ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqiave) dhe me ata që janë bëmirës.” (En - Nahl, 128)

Prandaj mos e haroni porosinë e All-llahut e cila iu është drejtuar mbarë njerëzimit, e ajo është:

“Feja e pranueshme tek All-llahu është Islami...” (Ali Imarn, 19)

TEWHIDI DHE LLOJET E TIJ

Definicioni i Tewhidit:

Dije - All-llahu të ka mëshiruar - që tewhidi domethënë: adhurimi i Njërit dhe të Vetmit All-llah xh.sh.

Kjo është feja e të gjithë të dërguarve dhe lajmëtarëve të fesë, të cilën All-llahu xh.sh. iu dërgonte robërve të Vet (njerëzve).

All-llahu i Madhërishëm thotë:

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë:

“Adhurone vetëm All-llahun, e largohuni djajve (adhurimit të tyre)!”...” (En - Nahl, 36)

Llojet e tewhidit:

Tewhidi ndahet në tri lloje:

1. Tewhidurr - rrububijjeti (të besuarit që vetëm All-llahu xh.sh. çdo gjë krijon dhe furnizon)

2. Tewhidul - uluhijjeti (të besuarit që vetëm All-llahut xh.sh. i takon që të adhurohet dhe vetëm Atij i takon që t’i nënshtrohemi).

3. Tewhidul - esmai wes - sifati (të besuarit që vetëm All-llahu posedon emra të përkryer dhe attribute - veçori).

TEWHIDURR - RRUBUBIJJETI

Tewhidurr - rrububijjeti domethënë: të besuarit në Njëshmërinë e All-llahut xh.sh. përmes veprave të Tij, sikurse që janë: krijimi, furnizimi, ringjallja, ndalimi, përcaktimi i çdo gjëje, lëshuarja e shiut dhe të ngjashme. Të gjitha këto dhe vepra të ngjashme janë qartë në kompetencat e Njërit dhe të Vetmit All-llah xh.sh. Këtë kategori të tewhidit e kanë pranuar jobesimtarët në kohën e Resulull-llahut s.a.w.s. por ky pranim nuk i ka drejtuar në Islam, çka dëshmojnë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Thuaj: “E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini ?” Ata do të thonë: “E All-llahut”. Atëherë thuaju: “Përse pra nuk mendoni ?” (El - Mu’minunë, 84-85)

“Nëse ti i pyet ata: “Kush krijoi qiejt e tokën ?” Me siguri do të thonë: “All-llahu!” (Llukman, 25)

TEWHIDUL - ULUHIJJETI

Tewhidul - uluhijjeti domethënë adhurimi i Njërit, të Vetmit All-llah xh.sh. dhe që vetëm Atij t’i drejtohen të gjitha format e ibadeteve dhe nënshtimit, sikur që janë: duaaja, sakrifikimi, betimi, të kërkuarit e ndihmës dhe shpëtimit, e të ngjashme. Këtë lloj tewhidi, jobesimtarët e kanë mohuar dhe e kanë braktisur, dhe ajo është mjet i përçarjes dhe i ndarjes mes të dërguarve dhe popujve të tyre, nga Nuhi a.s. dhe deri te i Dërguari i fundit, Muhammedi s.a.w.s.

TEWHIDUL - ESMAI WES - SIFATI

Kjo domethënë të besuarit në të gjithë emrat e All-llahut xh.sh. dhe veçoritë e Tij, të cilat janë të paraqitura në Kur'an dhe në hadithet e të Dërguarit s.a.w.s. (Sunnetin), në të cilat All-llahu i Madhërishëm e ka përshkruar Veten apo e ka përshkruar i Dërguari i Tij Muhammedi s.a.w.s.

All-llahu i Madhërishëm thotë:

“Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.” (Esh - Shuaraë,11)

SHIRKU - BESIMI NË SHUMË ZOTËRA - DHE LLOJET E TIJ

Shirku është ai që është i kundërt me tewhidin (besimin në një Zot), ndërsa ndahet në tri pjesë: të fshehur, të vogël dhe të madh.

SHIRKU I FSHEHUR

Shirku i fshehur përmendet në hadithin, në të cilin i Dërguari i All-llahut xh.sh. thotë:

“Shirku te pasardhësit e ummetit tim është më i fshehur se sa thnegla e zezë nëpër shkëmbin e zi, në natën e errët”

Ibni Abbasi r.a. duke e cekur një shembull për këtë lloj shirku,

ka thënë: “Ai është sikurse kur njeriu i thotë shokut të vet: “Atë çka e do All-llahu e do edhe ti”, ose kur njeriu thotë: “Të mos ishte All-llahu dhe ai njeri, do të ishte...” Pastrimi nga ky lloj shirku arrihet duke i thënë këto dua të të Dërguarit s.a.w.s.: “All-llahu im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga bërja e shirkut të cilin e di (që është shirk) dhe të lutem të më falësh mëkatin (shirkun) të cilin nuk e di.”

SHIRKU I VOGËL

Shirku i vogël është shtirja (do të thotë të bësh ndonjë lloj të ibadetit për të të parë dikush se si po e kryen atë).

Ky lloj shirku përmendet në ajetin Kur'anor, ku All-llahu xh.sh. thotë:

“...e kush është që shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëj vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziej askë.” (El - Kehf, 110)

SHIRKU I MADH

Ky lloj shirku përmendet në këtë ajet Kur'anor:

“Është e vërtetë se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, e pos këtij, të tjerat i falë atij që dëshiron. Ai që i përshkruan shok All-llahut, ai ka humbur dhe bërë një largim

të madh (prej së vërtetës).” (En - Nisaë, 116)
All-llahu xh.sh. gjithashtu thotë:
“Bënë kufër (mohuan të vërtetën) ata që thanë: “All-llah është ai, Mesihu, biri i Merjemes.” E vet Mesihu (Isai) tha: “O beni israil, adhuronie All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhennetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.” (El - Maide, 72)

LLOJET E SHIRKUT TË MADH

Shirku i madh ka katër lloje:

1. Shirku në të drejtuarit e tjetërkujt me dua përveç All-llahut xh.sh.

Ky lloj shirku përmendet në këtë ajet Kur'anor:

“**Kur hipin ata** (idhujtarët) **në anije** (u këputet lidhja me tokën dhe frikësohen) **i luten singërisht All-llahut, e kur i shpëton ata** (dhe dalin) **në tokë, qe, po ata të njejtit lusin idhuj!**” (El - Ankebutë, 65)

2. Shirku në nijjetet, dëshirat dhe qëllimet.

Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“**Kush ka për qëllim jetën e kësaj bote dhe të mirat e saj, Ne do t’u plotësojmë atyre shpërblimin e veprave të tyre në të, dhe atyre nuk do t’u mungojë gjë. Të këtillëve në botën tjetër**

u përket vetëm Xhehennemi. Ajo që punuan dhe vepruan ka dështuar dhe është asgjësuar.” (Hudë, 15 - 16)

3. Shirku në dëgjueshmeri - përlulshmeri.

Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Ata i konsideruan “ahbarët” (priftërit jehud) të tyre, “ruhbanët” (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun birin e Merjemes, për zotëra pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut Një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I Lartë është Ai nga çka i shoqërojnë.” (Et - Tewbe, 31)

Me këtë mendohet që ata kanë qenë të dëgjueshëm ndaj dijetarëve dhe priftërinjëve në mëkate, e nuk mendohet që i kanë adhuruar ata, sikurse që i Dërguari s.a.w.s. ia ka shpjeguar Adij ibn Hatimit kur e ka pyetur lidhur me këtë, ai i ka thënë: “Ne ata nuk i adhurojmë”, mandej i Dërguari s.a.w.s. tha: “ Dëgjueshmëria ndaj tyre në mëkate, është adhurimi i tyre.”

4. Shirku në dashuri.

Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“E nga njerëzit ka të tillë që në vend të All-llahut besojnë idhujt që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) All-llahun, po dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë. E sikur të dinin ata që bënë mizori se kur do ta shohin dënimin (në botën tjetër), do të binden që e tërë fuqia i takon vetëm All-llahut (e jo idhujve) dhe se All-llahu është Ndëshkues i rreptë.” (El - Bekare, 165)

KUFRI - MOSBESIMI - DHE LLOJET E TIJ

Ekzistojnë dy lloje të kufrit: i vogël dhe i madh.

KUFRI I VOGËL

Ky është kufri i cili bërësin nuk e nxjerrë nga feja, e ai është mosbesimi (mohimi) i të mirave. Dëshmi e kësaj janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurtë dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun e urisë dhe të frikës.” (En - Nahl, 112)

KUFRI I MADH

Ky është kufri i cili bërësin e nxjerrë nga feja dhe ndahet në pesë lloje:

1. Kufri i mosbesimit.

Dëshmi e kësaj janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“E kush është më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut, ose përgënjeshtroi të vërtetën pasi t’i ketë ardhur ajo? Po a nuk është Xhehennemi vend për jobesimtarët?” (El - Ankebutë, 68)

2. Kufri i refuzimit dhe mendjemadhësisë.

Dëshmi e kësaj janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“E kur u thamë melaikeve: përuluni (bini në sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përulën, me përjashtim të Iblisit (djallit). Ai refuzoi dhe u mbajt në të madh dhe u bë pabesimtar.” (El - Bekare, 34)

3. Kufri i dyshimit dhe lëkundshmërisë.

Dëshmi e kësaj janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Dhe ai hyri në kopshtin e vet (me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetes (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: “Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë!”, “Dhe nuk besoj se do të ndodhë Kijameti (Dita e Gjykimit), por nëse bëhem të kthehem te Zoti im, pa dyshim do të gjejë ardhmëri edhe më të mirë se kjo.”, “Atij, ai shoku (besimtari) i tha - duke e polemizuar atë : “A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë?”, “Por për mua, Ai All-llahu është Zoti im, e Zotit tim unë nuk i bëj shok askë.” (El - Kehf, 35 - 38)

4) Kufri i shmangies nga udhëzimi.

Dëshmi janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Ngase ata besuan me gojë, e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë.” (El - Munafikunë, 3)

NIFAKU - DYFTYRËSIA - DHE LLOJET E TIJ

Nifaku ndahet në: nifakun në zemër dhe në vepra:

E para: Nifaku në zemër ndahet në gjashtë lloje:

1. Mohimi i të Dërguarit të All-llahut - Muhammedit s.a.w.s.
 2. Të mohosh atë me çka ka ardhur i Dërguari i All-llahut.
 3. Përbuzja - mospërfillja - e të Dërguarit të All-llahut.
 4. Të përbuzurit e asaj me çka ka ardhur i Dërguari i All-llahut.
 5. Të gëzuarit e dobësimit të fesë së të Dërguarit të All-llahut.
 6. Të përbuzurit e përparimit të fesë së të Dërguarit të All-llahut.
- Këto janë gjashtë lloje të nifakut dhe ai tek i cili gjenden këto, do të jetë në shkallën më të ulët të Xhehennemit.

E dyta: Nifaku në vepra ndahet në pesë lloje:

Dëshmi për këtë janë fjalët e të Dërguarit të All-llahut:

“Veçoritë e munafikut janë tri (e ato janë):

1. *Kur flet, gënjen.*
2. *Kur premtion, nuk e kryen premtimin.*
3. *Kur diçka i besohet, ai atë e shpërdoron.”*

Dhe në hadithin e dytë:

3. *Kur diskuton (përllahet), e tejkalon kufirin.*
4. *Kur obligohet, mashtron.*

Kërkojmë mbrojtjen e All-llahut nga nifaku (munafikllëku), ndarja dhe edukata e shëmtuar.

PËR DOMETHËNIEN E FJALËS “TAGUT”

Obligimi i parë me të cilin All-llahu xh.sh. i ka obliguar njerëzit:

Dije, All-llahu të ka mëshiruar, që obligimi i parë me të cilin All-llahu xh.sh. i ka obliguar njerëzit është ta adhurojnë vetëm Atë dhe ta mohojnë vetinë e hyjnive përveç Tij.

Emër i përbashkët për çdo gjë që adhurohet, të përshkruarit vetes veçori apo privilegie (prerogativë) hyjnore, pranë All-llahut, është “Tagut”

Sipas kësaj, çdo njeri, kafshë, send, ose diçka tjetër, të cilëve njerëzit i luten ose i adhurojnë, konsiderohet “Tagut”.

Dëshmi për obligimin e dhënë janë fjalët vijuese të All-llahut xh.sh.:

**“Ne dërguam në çdo popull (të Dërguar) që t’u thonë:
“Adhuroni vetëm All-llahun, e largohuni djajve
(tagutëve)!”...”** (En - Nahl,36)

SI TA SHPREHIM MOSBESIMIN NË “TAGUT”?

Të shprehurit e mosbesimit në “Tagut” domethënë: të besojmë me vendosmëri në pasaktësinë e adhurimit në diçka tjetër përveç All-llahut, braktisja e adhurimit të tillë, përbuzja e saj, të konsideruarit për jobesimtar atë i cili i adhuron dhe marrja e qëndrimit armiqësor ndaj tij.

ÇKA DOMETHËNË TË BESUARIT NË ALL-LLAHUN XH.SH.?

Të besuarit në All-llahun xh.sh. domethënë: Që fuqimisht dhe vendosmërisht të besosh që vetëm All-llahu xh.sh. meriton t'i nënshtrohem i dhe ta adhurojmë, pos çdo gjëje tjetër, që të gjitha format e ibadetit - të nënshtrojarit pendueshëm t'i drejtojmë vetëm All-llahut xh.sh., duke ia mohuar këtë të drejtë të gjitha hyjnive (idhujve) tjera të rrejshme, t'i duash robërit e singertë të All-llahut xh.sh. dhe me ta të shoqërohesh, t'i përbuzësh mushrikët - politeistët (idhujtarët) dhe që armiqësisht të paraqitesh ndaj tyre. Ai është “milet” (populli) - feja e Ibrahimit a.s. për të cilën All-llahu i Madhërishtëm thotë:

“E kush largohet prej fesë së Ibrahimit përveç atij që poshtëron vetvetën ...” (El - Bekare, 130)

Dhe ky është një shembull i bukur për të cilin All-llahu xh.sh. na ka lajmëruar me fjalët:

“Ju e keni shembullin më të mirë te Ibrahim i dhe te ata të cilët ishin me të, kur i thanë popullit të vet: “Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuron, pos All-llahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh dhe jush është e

hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm All-llahun Një!”...” (El - Mumtehine, 4)

KUSH ËSHTË “TAGUT”

Fjala “Tagut” përfshinë çdo gjë që adhurohet përveç All-llahut dhe që është i kënaqur të jetë i adhuruar, sikurse që përfshinë çdo gjë që pasohet dhe që nënshtrohet në atë çka All-llahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar.

“Tagut” ka shumë, e kryesor janë pesë:

1. Ibli si shejtani, i cili tthërret të adhurohet dikush tjetër përveç All-llahut xh.sh. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“O bijt e Adem (kriminel) po anuk u dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët?!”, “Të më adhuron Mua, se kjo është rruga e sigurt?”
(Jasin, 60 - 61)

2. Sundimtari i padrejtë, i cili i ndryshon urdhërat (ligjet) e All-llahut të Madhërishëm. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që në mes tyre të gjykojë djalli, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t’i humbë në pafundësi.” (En - Nisaë, 60)

3. Ai, i cili nuk gjykon sipas asaj që All-llahu xh.sh. e ka shpallur. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:
“...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues.” (El - Maide, 44)

4. Ai, i cili pretendon se e di të fshehtë (falltorët, magjistarët, sihirbazët, etj.). Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt.”, **“Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do. Atëbotë Ai vë roje edhe para edhe prapa tij (kur i shpall fshehtësinë).”** (El - Xhinn, 26 - 27)

“Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shenuar) në librin e qartë (Lewhi Mahfudh).” (El - En’amë, 59)

5. Ai, i cili me kënaqësinë e tij, adhurohet përveç All-llahut. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Ndërsa, kush thotë prej tyre se unë jamë zot pos Tij, ndëshkimi për të është Xhehennemi. Kështu i ndëshkojmë Ne zullumqarët.” (El - Enbija ,29)

KUR, NJERIU KONSIDEROHET BESIMTAR TE ALL-LLAHU XH.SH.?

Dije që njeriu nuk konsiderohet besimtar te All-llahu xh.sh. derisa nuk e mohon “Tagutin”. Këtë e dëshmojnë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është Dëgjues i Dijshëm.” (El - Bekare, 156)

Litari - lidhja - më e fortë është shehadeti: LA ILAHE IL - LALL - LLAH, e ai e përmban mohimin dhe pohimin. Mohimin e të gjitha llojeve të ibadetit dhe të nënshtuarit dikujt tjetër përveç All-llahut xh.sh. dhe pohimi që të gjitha trajtat dhe format e ibadetit dhe të nënshtuarit i takojnë vetëm All-llahut xh.sh., i cili nuk ka shok.

VEPRAT TË CILAT TË NXJERRIN NGA FEJA - ISLAMI

Dije që janë dhjetë veprime - punë, të cilat të nxjerrin nga Islami, e besimtarin e bëjnë jobesimtar:

1. Kush bënë shirk - All-llahut i përshkruan shok, bëhet jobesimtar. All-llahu i Madhërishëm thotë:

“S’ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok, e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh.” (En - Nisaë ,48)

“...ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (bërë

haram) **atij Xhennetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.**” (El - Maid, 72)

2. Kush bënë ndërmjetësues mes All-llahut dhe vetes, u lutet atyre, kërkon nga ata shefa’at (ndërhyrje) dhe mbështetet në ta, bëhet jobesimtar. Ky është mendimi i të gjithë ulemave - dijetarëve Islam.

3. Kush nuk i konsideron mushrikët - politeistët si jobesimtar, dyshon në mosbesimin e tyre, bëhet jobesimtar.

4. Kush mendon se udhëzimi i tjetërkujt është më i drejtë dhe më i plotë se sa udhëzimi i Lajmëtarit të fesë (Muhammedit s.a.w.s.), ose që ligji i dikujt tjetër është më i mirë se sa ligji i tij - sikur ata që i japin përparësi ligjeve të “Tagutit” (sunduesve të padrejtë) mbi të Dërguarin - bëhet jobesimtar.

5. Kush nuk e duron ndonjë urdhër me të cilin i Dërguari s.a.w.s. ka ardhur, po edhe nëse e ka zbatuar në praktikë, bëhet jobesimtar.

6. Kush tallet me diç nga feja e të Dërguarit s.a.w.s. ose tallet me ndonjë shpërblim ose dënim të fesë bëhet jobesimtar. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: **“...Thuaj: “A me All-llahun, Librin dhe të Dërguarin e Tij talleni?”**, **“Mos kërkonit fare ndjesë, ju pasiqë (shpallët se) besuat, keni mohuar...”** (Et - Tewbe, 65 - 66)

7. Sihri - magjija, në çka bëjnë pjesë ndarja dhe bashkimi (futja e urrejtjes përkatësisht dashurisë në mes personave të caktuar).

Kush e bënë atë ose është i kënaqur me atë, bëhet jobesimtar. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: **“...Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bë jobesimtar!”** (El - Bekare, 102)

8. Kush i përkrah mushrikët dhe iu ndihmon atyre kundër muslimanëve, bëhet jobesimtar.

9. Kush beson që disa njerëzve iu është lejuar të dalin nga kornizat e Sheriatit (Ligjit Islam), bëhet jobesimtar.

10. Kush sprapset - largohet nga feja e All-llahut, duke mos u munduar ta njohë dhe të veproj sipas saj, bëhet jobesimtar. Dëshmi për këtë janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

“...E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtetë All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë.” (El - Maide, 51)

“E kush është më zullumqar se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmirremi kundër kriminelëve.” (Es - Sexhde, 22)

Të gjitha veprimet e cekura të nxjerrin nga Islami, duke i bërë ato me qëllim ose me tallje, nga frika ose nën kërcënim. Këto paraqesin rrezik të madh dhe njerëzit në to shpesh herë edhe bien, prandaj muslimani është i detyruar të kujdeset nga ato dhe të kujdeset që të mos e bëj ndonjërin nga ato (vepra).

E lusim All-llahun që të na ruaj nga ajo që e nxitë zemërimin e Tij dhe dënimin e dhëmbshëm, përsëendetja dhe shpëtimi qofshin mbi robin e Tij më të zgjedhur - Muhammedin s.a.w.s., familjen e tij dhe as'habët - shokët e tij.

VËREJTJE, faqe 17

Në vend të:

"Ngase ata besuan me gojë, e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë më."(El-Munafikunë, 3)

Duhet të jetë:

"... por jobesimtarët i kthejnë kokat (duke i ikur) asaj me çka iu kërcënohet."

Dhe mungon teksti:

5) Kufri i nifakut (hipokrizisë - dyftyrësisë):

Dëshmi janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm:

"Ngase ata besuan me gojë e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë." (El Munafikunë, 3).

P Ë R M B A J T J A

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!	3
NJIHE ZOTIN - SUNDUESIN TËND.....	3
NJIHE LAJMËTARIN E FESË - MUHAMMEDIN S.A.W.S.....	5
NJIHE FENË TËNDE - ISLAMIN.....	6
ISLAMI	7
IMANI - TË BESUARIT.....	9
IHSANI - BËMIRËSIA.....	9
TEWHIDI DHE LLOJET E TIJ.....	10
TEWHIDURR - RRUBUBIJJETI.....	11
TEWHIDUL - ULUHIJJETI.....	11
TEWHIDUL - ESMAI WES - SIFATI.....	12
SHIRKU - BESIMI NË SHUMË ZOTËRA - DHE LLOJET E TIJ.....	12
SHIRKU I FSHEHUR.....	12
SHIRKU I VOGËL	13
SHIRKU I MADH	13
LLOJET E SHIRKUT TË MADH.....	14
KUFRI - MOSBESIMI - DHE LLOJET E TIJ.....	16
KUFRI I MADH.....	16
NIFAKU - DYFTYRËSIA- DHE LLOJET E TIJ.....	18
PËR DOMETHËNIEN E FJALËS "TAGUT".....	19
SI TA SHPREHIM MOSBESIMIN NË "TAGUT".....	19
ÇKA DOMETHËNË TË BESUARIT NË ALL-LLAHUN XH.SH.....	20
KUSH ËSHTË "TAGUT".....	21
KUR, NJERIU KONSIDEROHET BESIMTAR TE ALL-LLAHU XH.SH.....	22
VEPRAT TË CILAT TË NXJERIN NGA FEJA-ISLAME.....	23